

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaTop®-10

### PRAJMER ME BAZË UJI PËR NËNSHTRESA ÇIMENTOJE

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

- Prajmer me bazë rrëshire sintetike kopolimeresh stireni-akriliku, me lëndë mbushëse minerale.
- Pjesë e serisë Sika® EmotionFloor për nënshtresa çimentoje dhe pllaka.

#### PËRDORIMET

- Posaçërisht për përdorim si prajmer për SikaDecor®-803 Nature
- Mbi nënshtresa minerale, veshje çimentoje dhe pllaka të vjetra qeramike
- Nuk është i përshtatshëm për sipërfaqet vertikale

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ndërkapje e shkëlqyer mbi nënshtresa poroze dhe qelqi
- Parandalon humbjen e ujit tek nënshtresa
- Ekonomik
- Shton rezistencën
- Rezistencë ndaj pH alkaline
- Gati për përdorim
- Përdorim i lehtë
- Për nënshtresa me përmbajtje më të madhe lagështie

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Kopolimere stireni-akriliku me lëndë mbushëse minerale		
<b>Ambalazhi</b>	Kovë:	5 kg	20 kg
	Paletë e plotë:	96 x 5 kg (480 kg)	33 x 20 kg (660 kg)
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	E kuqërremtë me lëndë mbushëse		
<b>Jetëgjatësia</b>	Në ambalazhin origjinal të padëmtuar dhe të mbyllur: 12 muaj nga data e prodhimit		
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga ngrirja. Të ruhet në kushte të thata.		
<b>Dendësia</b>	~ 1.32 kg/l		(+20 °C)
<b>Viskoziteti</b>	~ 13 770 mPas		(+20 °C, Brookfield S64, 20 rpm)

#### INFORMACIONE MBI SISTEMIN

<b>Struktura e sistemit</b>	Ju lutemi referohuni në skedën teknike të: SikaDecor®-803 Nature:		Për Sika® EmotionFloor të aplikuar si një veshje dekoruese muri
-----------------------------	--	--	---

# INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Konsumimi</b>	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup> /shtresë  Disa nënshtresa kërkojnë konsumim më të madh sesa tregohet.  Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel, firon, etj.						
<b>Temperatura e mjedisit</b>	Min. +10 °C, max. +30 °C Temperatura gjatë tharjes duhet të bjerë nën temperaturën minimale.						
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	Min. +10 °C, max. +30 °C Temperatura gjatë tharjes duhet të bjerë nën temperaturën minimale.						
<b>Lagështia e përmbajtur e nënshtresës</b>	Mund të aplikohet mbi nënshtresa me përmbajtje më të lartë lagështie. Pa pëllg uji. Nënshtresa duhet të jetë e thatë në pamje.						
<b>Koha e maturimit</b>	<b>Përpara aplikimit të SikaDecor®-803 Nature mbi SikaTop®-10 lini:</b> <table><thead><tr><th>Temperatura e nënshtresës</th><th>Min.</th><th>Max.</th></tr></thead><tbody><tr><td>+20 °C</td><td>1 orë</td><td>-</td></tr></tbody></table> Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.	Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.	+20 °C	1 orë	-
Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.					
+20 °C	1 orë	-					

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

#### Cilësia e nënshtresës

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme.

E pastër dhe pa kontaminues si pislleqet, vaji, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj.

#### Trajtimi paraprak

Nënshtresat duhet të jenë përgatitur mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive ose shkriftor për të përfutur një sipërfaqe me teksturë të hapur.

Pllakat duhet të bluhën.

Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë ose fshesë thithëse.

### PËRZIERJA

SikaTop®-10 është gati për përdorim.

Homogjenizoni materialin përpara aplikimit për të paktën 1 minutë.

Përdorni mikser me shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm).

### APLIKIMI

Aplikoni me furçë ose rul për të arritur depërtim dhe performancë më të madhe.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë

menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Në mot të nxehtë (mbi +25°C) SikaTop®-10 të ruhet në vend të freskët përpara përdorimit.
- Në temperatura të ulëta (nën +15°C) produkti mund të trashet dhe të reduktojë punueshmërinë.
- Mos përdorni produktin që ka ngrirë.
- Në rast dyshimi, aplikoni më parë në një zonë për provë.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaTop®-10

Mars 2019, Botimi 01.01

020404030010000022

SikaTop-10-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf